

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – koleji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta kryetar koleji, Salih Toplica dhe Nebojsa Boricic, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi , në çështjen penale kundër të pandehurve H. H. dhe Sh. S., për shkak të veprës penale në bashkëveprim vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkritazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga mbrojtësit e të pandehurve av. M.H. dhe av. H.P., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Ppr.nr.6/2016 datë 11.3.2016 dhe aktvendimit te Gjykates së Apelit në Prishtine Pn1.nr.443/2016 date 16.3.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.3. 2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve H.H. dhe Sh. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë Ppr.nr.6/2016 datë 11.3.2016 dhe aktvendimit te Gjykates së Apelit në Prishtine Pn1.nr.443/2016 date 16.3.2016.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë–Dega në Podujevë-departamenti i përgjithshëm , me aktvendimin Ppr.nr.6/2016 datë 11.3.2016, të pandehurve H. H. dhe Sh.S. iu ka caktuar paraburgimin në kohëzgjatje prej 1(një) muaji, prej datës 10.3.2016 deri më

datën 10.4.2016, për shkak të vepres penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konform dispozitës së nenit 187 të KPP par 1 nënpar 1.1 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn1.nr.443/2016 date 16.3.2016, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe është vërtetuar aktvendimi i shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurve

- av.H.P. për të pandehurin H. H., për shkak të shkeljeve esenciale nga neni 432 pika 1.1,1.2 dhe neni 187 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi dhe i njejtë të mbrohet në liri apo ti zëvendësohet me ndonjë masë tjetër alternative,

- av.M. H. për të pandehurin Sh.S., për shkak të shkeljeve esenciale nga neni 432 pika 1.1,1.2 dhe neni 187 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit apo ti caktohet masa e paraqitjes në polici.

Përgjigje në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve , ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.III.nr.24/2016 datë 30.3.2016, në të cilën propozon që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Që në fillim duhet theksuar se nga referati i kërkesave të mbrojtësve rezulton se mbrojtësit e të pandehurve nuk kanë përmendur asnjë shkelje konkrete të dispozitave të ligjit penal apo procedural, por që të dy kërkesat e mbrojtësve të të pandehurve janë identike dhe kanë pretendime të njejta për ndërpreje të masës së paraburgimit, ngase sipas tyre edhe me ndonjë masë më të butë do të arrihej sigurimi i pranisë së të pandehurve në procedurë, nga se të panehurit i kanë pranuar veprimet e veta dhe kanë garantuar se nuk do të largohen nga vendi i tyre dhe nuk do ta përsërisin vepër penale, andaj edhe pretendojnë se në aktvendimet e kundërshtuara nuk qëndrojnë asnjë nga arsyet ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, ngase nga shkresat e lëndës e konkretisht nga kallzimi penal-stacioni Policor në Podujevë me nr.2016-AF-0195 të datës 11.3.2016, deklaratave të të dyshuarve, kërkesa për caktimin e paraburgimit, aktvendimi mbi fillimin e hetimeve, informacionet e policisë lidhur me të kaluarën kriminale për këta persona, rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se të panehurit kanë kryer veprat penale në drejtim të së cilave janë duke u zhvillur hetimet.

Duhet theksuar se në rastin konkret në këtë çështje penale edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate qëndrojnë bazat ligjore për caktimin e paraburgimit, siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë e të cilat si të drejta dhe të bazuara i pranon edhe kjo gjykatë, nga se të njejtat në arsyetimet e vendimeve të atakuara kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën iu kanë caktuar paraburgimin të pandehurve, konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së. Duke pasur parasysh peshën e rëndë të kësaj vepre penale, pastaj karakteristikat e mëparshme të të pandehurve, ku nga shkresat e lëndës rezulton se ndaj tyre janë duke u zhvilluar edhe procedura tjera penale si dhe fakti se i pandehuri H.H. dyshohet për 40 vepra penale të llojit të njejtë, kurse Sh.S. dyshohet edhe për 5 vepra tjera penale. Andaj duke i pas parashysh rrethanat e përmendura ekziston rreziku se po të gjenden të panehurit në liri, do të mund të ndikojnë në dëshmtarë - të dëmtuarit të

cilët ende nuk janë dëgjuar dhe mund të përsërisin veprat e njejta apo të ngjashme dhe në këtë mënyrë do të pengojë zhvillimi i rregullt i procedurës penale në këtë çështje penale.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur të fakteve vendimtare, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë aktvendimin duke dhënë edhe arsye të mjaftueshme, dhe të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Për shkak të rrethanave të lartcekura, dalin të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve në lidhje me ndërprerjen e paraburgimit, andaj sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.89/2016, më 31.3.2016

B.profesionale  
Minire Xhambazi

Kryetarja e kolegjit,  
Nesrin Lushta